



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M
Nr. 25, date 26.6.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.1, DATË 22.1.2016 "PËR TAKSAT DHE
TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR", TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 26.6.2020, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, shkronja "a" nenit 35, neneve 54/f dhe 55/3 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", të ndryshuar, ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile" Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.18/2020 "Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", Akti normativ nr.11, datë 27.3.2020 "Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar; Akti normativ nr.10, datë 26.3.2020 "Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKB nr.16, datë 3.4.2020 "Për miratim rezolute", pasi shqyrtoi projekt-vendim ardhur nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër me nr.86, datë 19.3.2020, prot.4974, datë 19.3.2020, shkresën e Kryetares së Këshillit Bashkiak nr.5328, datë 8.4.2020, shkresën e Kryetares së Bashkisë nr.5328/1, datë 8.5.2020, shkresat nr. nr.8892/1 dhe 8892/2 datë 25.6.2020, propozimeve të tjera të bërë nga këshilltarët gjatë mbledhjes, me 28 vota Pro,

V E N D O S I

1. Miratimin e ndryshimeve në VKB nr.1, datë 22.1.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër, të ndryshuar.
2. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 3 mujore të vitit 2020, për të gjitha bizneset me xhiro vjetore deri në 14 milion, ambulantët dhe OJF, në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative.

Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Shkodër duhet të administrojë vërtetim të xhiros vjetore të vitit 2019 për subjektet përfituese, të nxjerrë nga portali e-Albania (pa pagesë).

Subjektet përfituese të cilat kanë paguar detyrimet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, vlera e falur për periudhën 3 mujore, do t'u njihet si tepricë kreditore për vitin e ardhshëm.

3. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 6 mujore të vitit 2020, kategoritë si më poshtë vijon:
 - Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes.
 - Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)
 - Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç)

në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative

4. Shtyerjen e afatit të pagesave të taksave dhe tarifave vendore deri me datë 30 tetor 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve:
 - Individë, familje;
 - Persona fizik dhe juridik, ambulant;
 - OJF, Institucione publike;

në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative

5. Të përjashtohen nga kamatvonesat e detyrimeve vendore dhe gjobave për të gjitha kategoritë e taksapaguesve:
 - Individë, familje;

- Persona fizik dhe juridik, ambulant;
- OJF, Institucione publike;

në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
7. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të hartojë dhe paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak, buxhetin e Bashkisë Shkodër, të rishikuar si rezultat i efekteve financiare të krijuara për shkak të këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit



Denis Lesha

KRYETARE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 488/1 prot

Shkodër, më 30.06.2020

LËNDA: Mbi VKB Shkodër Nr.25, datë 26.06.2020 “Për disa ndryshime ne VKB nr.1 datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër” i ndryshuar.

KESHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, ligjit Nr.139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore” i përditësuar neni 9 pika 1.3 shkronja “b”, neni 35 pika 1, nenit 54 shkronja “f”, neni 55/3, neni 64/c, të Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, Aktit normativ nr.10 dt.26.03.2020 “Per nje ndryshim ne ligjin Nr.8438 dt.28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, Aktit normativ Nr.11 datë 27.03.2020 “Per nje shtese ne ligjin nr.9632 dt.30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, *shqyrtoi VKB Shkodër Nr.25 datë 26.06.2020 “Për disa ndryshime në VKB nr.1 dt.22.01.2016 “Për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër” i ndryshuar për një periudhë 3 mujore¹.*

Situata ligjore e kësaj vendimmarrjeje si vijon:

Projekt vendimi nr.86 datë 19.03.2020 (4974 prot) sipas propozimit të organit ekzekutiv mbi ndryshim të taksave dhe tarifave vendore (ulje dhe përjashtime) daton që nga muaji mars 2020, përpara shpalljes së fatkeqësisë natyrore me VKM Nr.243 datë 24.03.2020 “Per shpalljen e gjendjes se fatkeqesise natyrore” i ndryshuar.

Referuar nenit 35 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, bashkitë krijojnë të ardhura nga taksat² dhe tarifave vendore sipas vendimmarrjes së këshillit bashkiak, neni 54 gërma f, ligj nr.139/2015,

Këshilli bashkiak sipas nenit 6, gërma c e ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” “*rishikon politikat fiskale vendore, në përputhje me aktet ligjore në fuqi*”,

Këshilli bashkiak përcakton përjashtimet, ulje apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish,

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton, me vendim, nivelin e tarifave vendore, përfshirë përjashtimet e lehtësimet, afatet dhe metodat e pagesës së tarifave.

¹ Nuk janë cituar muajt, por sipas referencës suaj ligjore periudha e fatkeqësisë natyrore fillon me datën 24.3.20 deri me datën 23.6.20.

²“Taksë vendore” është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë, niveli i së cilës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore, Për sa trajtuar, referuar Urdhërit të Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Prefektit të Qarkut Shkodër nr. 54, datë 17.05.2019 “Për delegim kompetence për firmë”, ju autorizohet procedimi i mëtejshëm.

Përsa i përket pikës pesë të VKB në të cilën citohet: *Të përjashtohen nga kamatvonesat e detyrimeve vendore³ dhe gjobave të gjitha kategoritë e taksapaguesve, si individë, familje, persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF, Institucione publike në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJAD*”, është jo në përputhje me procedurat ligjore e parashikuara në nenin 76 dhe 114 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar, madje kjo është miratuar shumë vonë, ndërkohë që këshilli bashkiak duhej të kishte dijeni për afatin 30 qershor i përcaktuar në vetë VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dher tarifat vendore në Bashkinë Shkodër” i ndryshuar, e cila mund të ketë sjellë penalitete për taksapaguesit.


Lidhur me terminologjinë “tepricë kreditore” cituar në VKB, ju sqarohet se vendimit mund t’i jepnit fuqi prapavepruese si avantazh për qytetarin.

Ju rekomandohet që struktura përkatëse pranë bashkisë Shkodër të vlerësojë nëse mund të aplikojë nenin 75 të ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Felek KASEMI



³ E paspecifikuar se cilat nga paketa fiskale